



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

KOMUNA E PRISHTINËS

01. Nr. 085-157708, më 23.06.2016

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15 qershor 2008) të nenit 13, 37, 57, 59, 60 të Ligjit 04/L-027 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 22/11 Nëntor 2011) të dispozitave të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391 të dt. 25.02.2010, Kryetari i Komunës së Prishtinës, me 23.06.2016 lëshon, këtë:

URDHËRESË

- I. **URDHEROHET** evakuimi i banorëve të objektit të banimit individual, i cili gjendet në rrugën Fehmi Agani, përkatësisht në parcelën kadastrale 6275.
- II. Evakuimi i banorëve nga objekti i cekur në pikën 1 të kësaj urdhërese bëhet për shkak të rrezikshmërisë së konstatuar nga zyrtarët e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit gjatë kontrollit të bërë sipas detyrës zyrtare.
- III. **Obligohet** drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që të siguroj banim të përkohshëm për banorët e evakuar.
- IV. **Obligohet** Drejtorja e Inspektionit që të kujdeset që evakuimi i banorëve të kryhet urgjentisht dhe në përputhje me nivelin e rrezikshmërisë.
- V. **Obligohen** Drejtorja e Inspektionit dhe Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit që të i marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë edhe rrënimin e objektit dhe pastrimin e terrenit, në mënyrë që të evitohet rreziku për banorët e lagjes dhe kalimtarët e rastit.
- VI. Kjo Urdhëresë hyn në fuqi ditën e lëshimit.

I’u Dërgohet:

- Banorëve të Objektit
- Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
- Drejtorisë së Inspektionit;
- Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

KRYETARI I KOMUNËS
Shpend Ahmeti

